



Shoqëria "Abissnet"sha

NIPT: K01417001C

Adresa e selisë: Njësia Bashkiake Nr.5,

Rruga "Ismail Qemali", Pallati 18,

Kati II, Tiranë,

VENDIM NR. 4
DATE 09.03.2023

I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË "ABISSNET"SHA

Sot, më datë 09.03.2023, ora 11:00, në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati 18, Kati II, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "Abissnet"sha. Në këtë mbledhje është i pranishëm aksionari i vetëm i shoqërisë "Abissnet"sha, shoqëria "2K Group"shpk, e cila zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë "Abissnet"sha, përfaqësuar personalisht nga të gjithë ortakët e saj si më poshtë:

1. Koço Kokëdhima, i cili zotëron 65% të kapitalit të shoqërisë "2K Group" shpk
2. Brixhilda Kokëdhima, e cila zotëron 35% të kapitalit të shoqërisë "2K Group"shpk;

Mbledhja zhvillohet duke respektuar kuorumin e përfaqësimit, pasi është i pranishëm aksionari i vetëm "2K Group" shpk. Në bazë të nenit 144 dhe 145 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Në përputhje me njoftimin, rendin e ditës në mbledhjen e sotme është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë "Abissnet" sha mbështetur sipas gjendjes së bilancit me datë 31.12.2021, për gatitur nga eksperti kontabël i autorizuar, Bujar Rami me Licencë nr.90, datë 07.12.2000; NUIS L21501047E
2. Të ndryshme sipas propozimeve.

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Zmadhimit të Kapitalit dt. 16.02.2023 të shoqërisë "Abissnet"sha, sipas gjendjes së bilancit me datë 31.12.2021, për gatitur nga eksperti kontabël i autorizuar, Bujar Rami me Licencë nr.90, datë 07.12.2000; NUIS L21501047E;

2. Ne baze te ketij zmadhimi, kapitali i shoqërisë “Abissnet”sha bëhet 693,400,000 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre milion e katërqind mijë) Lekë, i ndarë në 693,400 aksione, me vlerë nominale të një aksioni 1000 Lekë si dhe rezervat ligjore bëhen 13,721,825 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e njëzet e pesë) Lekë.
3. Pas zmadhimit të kapitalit, zotërimi i tij nga aksionari i shoqërisë ndryshon si më poshtë:

nr	Aksionerët	ISHTE			BEHET		
		Numri i aksioneve	% pjesmarrjes	Kontrib.lek	Numri i aksioneve	% pjesmarrjes	Kontrib.lek
1	2K Group shpk	607,400	100	607,400,000	693,400	100	693,400,000
2	Shuma	607,400	100	607,400,000	693,400	100	693,400,000

Shoqëria “2K Group” shpk zotëron 693,400 aksione me vlerë nominale të një aksioni 1000 Lekë, të cilat përbëjnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë dhe me kontribut 693,400,000 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre million e katërqind mijë) Lekë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
AKSIONARI I VETËM
SHOQËRIA “2K GROUP”SHPK

Përfaqësuar nga:

1. **Koço KOKËDHIMA**

2. **Brixhilda KOKËDHIMA**

Brixhilda Kokëdhima

